



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Bf. 03-1406/1

03-06-2025 2025

Në bazë të nenit 41 n.l nenit 47 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 35/08, 1650/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/19) dhe neni 51 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/19) Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 26.05.2025, miratoi:

VENDIM PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është zgjedhur Afrim Fidani, gjyqtar i Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Ky vendim hyn në fuqi pas përfundimin të procedurës së plotëfuqishme dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Vendimin nr. 09-161/1 më 23.01.2025, publikoi shpallje për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 15/25, më 24.01.2025).


Sipas nenit 47 të Ligjit për Gjykatat, kryetari i gjykatës zgjedhet nga radhët e gjyqtarëve që kanë së paku gjashtë vjet përvojë gjyqësore të pandërprerë në gjykatë të nivelit të njëjtë ose më të lartë, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj, për një periudhë prej katër vjetësh, me të drejtën e zgjedhjes edhe një herë në gjykatë të të njëjtit nivel. Kryetar i gjykatës zgjedhet gjyqtari i cili është vlerësuar pozitivisht nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kandidati për kryetar në dokumentetë tjera dorëzonë Programin e punës gjatë mandatit që dota ket, me plan veprimi për zbatimin e programit.

Në pajtim me Rregulloren për mënyrën e formimit të komisionit për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës dhe plotësimin e kushteve për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës nga Ligji për gjykatat, Komisioni për verifikimin e afatit të aplikimeve dhe plotësinë e dokumenteve pas publikimit të shpallur për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri te Këshillit dorëzoi Raport me listën e propozuar për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 09-161/11 të datës 28.03.2025.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 26.05.2025, diskutoi dhe vendosi sipas renditjes së kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Çdo anëtar i Këshillit shpjegoi mënyrën e tij të votimit për kandidatin dhe kandidati Afrim Fidani mori shumicën e votave të nevojshme nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

Në përputhje me lart përmendur, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 26.05.2025, miratoi vendim për zgjedhjen e gjyqtarit Afrim Fidani për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT**
Kryetar
м-р Александар Камбовски
